



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:097739  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05644515

KE.nr.263/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të propozuesit të masës së përkohshme të sigurimit N.T.G. “BLEDI”, me numër fiskal 600178405, me seli në rr. “Gustav Mayer”, nr. 13, Prishtinë, N.T.SH. “NORD”, me numër unik identifikues 810912718, me seli në Pishtinë dhe N.T.G.I. “GRAFO-LONI” SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson F.Sh., avokat nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET i tërhequr propozimin për caktimin e masës së përkohshme me numër KE.nr 263/24 (2024:097739) e datës 26.03.2024 e paditësve N.T.G. “BLEDI”, N.T.SH. “NORD” dhe N.T.G.I. “GRAFO-LONI” SH.P.K., ndaj kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësit N.T.G. “BLEDI”, N.T.SH. “NORD” dhe N.T.G.I. “GRAFO-LONI” SH.P.K., përmes përfaqësuesit me autorizim me datë 26.03.2024, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ndaj kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të propozimit, me datën 29.03.2024 e ka obliguar propozuesin që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së vërejtjes për taksë, të paguaj taksën gjyqësore në

shumën prej 20 € dhe kopjen e fletëpagesës të ia dorëzoj gjykatës, duke e paralajmëruar propozuesin se propozimi do të konsiderohet i tërhequr po që se nuk veprohet sipas vërejtjes së lartcekur.

Fletëkthesa e postës për dorëzimin e vërejtjes për taksë është kthyer në gjykatë me datë 05.04.2024, ndërsa deri më datën 30.04.2024 nuk ka vepruar sipas vërejtjes për pagesë.

Andaj nisur nga fakti se paditësi pas pranimit të vërejtjes për taksën gjyqësore, nuk e ka paguar taksën gjyqësore deri në datën e lëshimit të këtij aktvendimi, gjykata duke u bazuar në nenin 253 paragrafin 5 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr propozimin e propozuesve N.T.G. “BLEDI”, N.T.SH. “NORD” dhe N.T.G.I. “GRAFO-LONI” SH.P.K., ndaj ndaj kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A., pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirimin e propozuesit nga detyrimi i pagesës së taksës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 253 par.5 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 263/24, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.